



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
**Nr.01-060/01-12830/23 datë: 23.05.2023**



Npi – 01/211 datë: 31.05.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale; Ligji për Financimin e Programeve të Veçantë të Banimit Nr.03/L-164; Ligji për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e Drejta Banesore Nr.04//L-061; Nenin 8 të Rregullores Komunale për Transparencë 01Nr.06/361/4, të datës 04.03.2009; Udhëzuesi për hartimin e Programeve Komunale trevjeçare të banimit; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2023 miratoi këtë:

**V E N D I M**

**PËR DISKUTIM PUBLIK  
TË PROGRAMIT TRE VJEÇAR PËR BANIM SOCIAL**

**I**


Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më 31.05.2023, unanimit, miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Programin tre vjeçar për banim social në komunën e Shtimes. Bartës të procesit të diskutimit publik janë: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni i hartimit të programit, dhe Zyra për Informim.

**II**

Vendimi është aprovuar duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive , Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi